

VENDIM
Nr. 574, datë 18.9.2024

**PËR DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN NR. 515, DATË 18.7.2003, TË KËSHILLIT
TË MINISTRAVE, “PËR MIRATIMIN E LISTËS SË INVENTARIT TË PRONAVE TË
PALUAJTSHME SHETËTËRORE, TË CILAT I KALOJNË NË PËRGJEGJËSI
ADMINISTRIMI MINISTRISË SË MBROJTJES”, TË NDRYSHUAR**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 8, pika 3, e 13, të ligjit nr. 8743, datë 22.2.2001, “Për pronat e paluajtshme të shtetit”, të ndryshuar, me propozimin e Kryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në vendimin nr. 515, datë 18.7.2003, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e listës së inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore, të cilat i kalojnë në përgjegjësi administrimi Ministrisë së Mbrojtjes”, të ndryshuar, bëhen ndryshimet e mëposhtme:

a) Në listën e inventarit, bashkëlidhur vendimit, përmasat e pronës nr. 998 zëvendësohen me përmasat e përcaktuara në formularin dhe plan-rilevimin, që i bashkëlidhen këtij vendimi dhe janë pjesë përbërëse të tij;

b) Prona me numër rendor 153, me emërtimin “Ish-reparti ushtarak nr. 1061/3”, me vendndodhje në Petrelë, Tiranë, hiqet nga lista e inventarit, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

2. Ngarkohen Ministria e Mbrojtjes dhe Agjencia Shtetërore e Kadastrës për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama

FORMULARI I PËRDITËSIMIT TË PRONËS

Identifikoi pronën Kapter Shkëlqim Isufaj / Specialist i Infrastrukturës dhe Pronave i RU 1002 (Emri, Mbiemri, Pozicioni Zyrtar) Institucioni Qendror Shtetëror Supervizor N/Kol Rexis Xhepa/Shef i Degës Logjistike i Forcës Tokësore (Emri, Mbiemri, Pozicioni Zyrtar) MINISTRIA E MBROJTJES Aprovoi Gjeneralmajor Ilir Xhebexhia / Komandant i Forcës Tokësore (Emri, Mbiemri, Pozicioni Zyrtar)												
Nr.	Zona Kadastrale Indeksi i Hartës	Numri i pasurisë	Lloji i pasurisë	Emërtesa e Pasurisë Adresa	Sip. e pasurisë (m2)	Nga sip		Funksioni që përdoret	Institucioni me përgjegjësi administrative / pronësi	Institucioni përdorues i pronës Statusi juridik i përdorimit	Inventarizuar me VKM	Të dhëna të tjera
						Truall (m2)	Ndërtesë (m2)					
998	8505 K-34-112- (224-C, 240-A)	1264/1	Truall	Ish Batalion Këmbësorie Kondras Berat	10760	2863		Për mbrojtjen	Ministria e Mbrojtjes Komanda e Forcës Tokësore (Reparti Usharak Nr. 1001)	Reparti Usharak Nr.1030	VKM Nr. 515 datë 18.07.2003, i ndryshuar me VKM Nr. 10, datë 11.01.2016	
		1266				4370						
		1267				3527						
		1267	Ndërtesë	Objekti Nr.1			35					
			Ndërtesë	Objekti Nr.2			130					
		1266/1	Ndërtesë	Objekti Nr.3			40					Inventarizuar vetëm ndërtesa
Totali					10760	10760	205					

Shënim: Objektet nr. 1, 2, pozicionohen në pasurinë nr. 1267 ndërsa objekti nr.3 megjithëse përfshihet në pasurinë nr. 1266/1 e cila nuk është llogaritur si pjesë e sipërfaqes totale të pronës nr.998 pasi nuk shtrihet në këtë pronë është llogaritur si komponent përbërës i saj, kjo për shkak se për këtë objekt nuk ka tituj pronësie për të tretet dhe ka qenë më parë komponent i pronës 998.

PLAN RILEVIMI PER PUNIME KADASTRALE
Prona nr.998 "Ish Batalion Këmborsie" Kondras, Velabisht, Berat

PRONARI: SHTET (MM)

DATË 15/01/2024

QËLLIMI: Përditësim, Regjistrim

VENDNDODHJA

Bashkia Berat DVASHK Berat Nr.Pasurisë 1264/1,1267,1266 Z.K 8505 Indeksi i Hartës K-34-112-(224-C, 240-A)


TE DHËNAT E PASURISË

Lloi i pasurisë Truall, Ullishte Sip e pasurisë 10760m² Sip e përgj. gjurmës së ndërtimit Nr. kateve Nr. pemeve

Nord = 497929.05
East = 4508236.06

KORNIZA REFERUESE GJEODEZIKE SHQIPTARE (KRGJSH)

Nord = 498368.96
East = 4508236.06



Nr. Orientimi	Perdorimi	Tipi i Kufirit	Kufitari	ID/Nr. P
1 Veri				K51726024H
2 Lindje				
3 Jug				
4 Perëndim				

REALIZOI PËR IGJIU
Topograf Ramiz Haxhiu

KONFIRMOI PËR IGJIU
DREJTORI MArch. Teuta KANXHERI

REALIZOI PËR ASHK
Specialisti
DVASHK
Nënshkrimi
KONFIRMOI
Përgjegjësi/Drejtori
Nënshkrimi/ Vula

TEKNOLOGJIA E MATJEVE: Z, O
PËRCAKTIMI I KUFIRIT: Sipas dokumentacionit arkivor.
Shënim: Ky plan rilevimi u rihartua në zbatim të shkresës të Komandës të Forcës Tokësore 6738/1, datë 26.12.2023. Bazuar në dokumentacionin hartografik arkivor, ortofoto e vitit 2015, statusit juridik (HTR, kartelat e pasurive) marrë nga DVASHK Berat.

PRONARI: SHTET, MM (Forca Tokësore)
MIRATOHET
KOMANDANTI I FORCËS TOKËSORE
Gjeneral Major Jir XHEBEXHIA

